



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më

Nr.

prot.

Data: 1.3.2025

Nr: 215

Ora: 17:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË VEPRIMTARIVE PUBLIKE TË BASHKISË
TIRANË PËR PERIUdhËN 16 SHKURT-22 SHKURT 2025**

Sot, më datë 1.3.2025, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me:

SUBJEKT: Bashkia Tiranë

OBJEKT: Shqyrtimi administrativ i veprimtarive publike të Bashkisë Tiranë për periudhën 16 shkurt-22 shkurt 2025.

BAZA LIGJORE: Nenet 19 pika 1, shkronja “n”, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

1. Gjatë periudhës 16 shkurt-22 shkurt 2025, **Bashkia Tiranë** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari me tematikë si më poshtë vijon:

- "Shpërndarje e apartamenteve nga programi 3%", raportuar në datë 17.2.2025 për t'u zhvilluar në datë 23.2.2025.

Veprimtaria e raportuar është në kundërshtim me nenin 92, pika 4, i Kodit Zgjedhor, i ndryshuar, dhe nenin 3, pika 1.3, shkronja “a” dhe “b”, i Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, i ndryshuar, për shkak të tematikës, dhe ka marrë shënimin “e ndaluar”, në sistemin elektronik të raportimeve (NDRI).

Data: 1.3.2025 Nr: 215
Ora: 17:00



“Për shqyrtimin administrativ të veprimtarive publike të Bashkisë Tiranë për periudhën 16 shkurt-22 shkurt 2025”

Janë marrë masa për të njoftuar AMA-të mos lejojë transmetimin apo pasqyrimin në rubrikat e lajmeve apo ato që mbulojnë fushatën në radio dhe televizione, gjithashtu janë dërguar dhe monitorues për të vëzhguar nëse do të zhvillohet apo jo veprimtaria, në kundërshtim me vendimin e ndalimit.

Nëpërmjet postës elektronike, administrata e KQZ-së i ka kërkuar Bashkisë Tiranë një informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes.

Pas njoftimit të kryer, personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të Bashkisë Tiranë ka dërguar pretendimet, duke sqaruar si vijon: “*Ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ka përcaktuar si një prej detyrimeve kryesore të bashkive garantimin e transparencës për publikun e gjerë gjatë ushtrimit të funksioneve dhe përmbushjes së detyrimeve që i janë ngarkuar nga legjislacioni në fuqi.*

Në vijim, ligji nr. 22/2018, “Për strehimin social”, të ndryshuar, synon krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm, për një jetesë të sigurt, me dinjitet duke u mbështetur në aftësitë paguese të individëve e të familjeve që kanë nevojë për strehim.

Me anë të ligjit sipërcituar, është parashikuar për herë të parë mënyra se si sektori privat kontribuon në krijimin e fondit publik të banesave sociale dhe konkretisht, bazuar në pikën 1, të nenin 19 të tij, parashikohet se çdo subjekt privat që pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, aplikon për leje zhvillimi dhe ndërtimi për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2 000 metra katrorë, siguron kalimin pa shpërblim të të paktën 3 për qind të sipërfaqes funksionale, me kushtet e një strehimi të përshtatshëm, në favor të fondit publik të banesave sociale.

Në zbatim të sa më sipër, aktualisht Bashkia Tiranë, ka marrë në dorëzim 35 apartamente, të cilët janë përfituar nga kontributi i sektorit privat në fondin publik të banesave, të disponueshëm për zbatimin e programit “Banesa Sociale me qira” dhe për rrjedhojë ka propozuar për miratim në Këshillin Bashkiak projektvendimin “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi social i strehimit “banesa sociale me qira” të apartamenteve të përfituara nga kontributi i sektorit privat”. Pas miratimit të këtij projektvendimi, është planifikuar kryerja e një organizimi me subjektet përfituese me qëllimin e ndërgjegjësimit/informimit të qytetarëve mbi këtë program social.

Realizimi i këtij organizimi nuk ka për qëllim shpërndarjen në veprimtari publike të lejeve të legalizimeve, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve dhe/apo shpërndarjen në veprimtari publike të akteve për regjistrimin e tokës bujqësore, certifikatave të pronësisë, dhe çfarëdolloj titulli pronësie sipas legjislacionit për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë, si dhe të regjistrimeve të titujve të pronësisë sipas ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën” në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve.

Ky program social ka në thelb dhënie me qira sociale, për një afat 1 vjeçar, të apartamenteve të përfituara sipas nenit 19, të ligjit 22/2018, të ndryshuar, subjekteve në nevojë të cilët përmbushin kriteret/kushtet për të përfituar sipas legjislacionit në fuqi për shërbimin social.

Në këtë kuptim, dëshirojmë t’iu informojmë se Bashkia Tiranë, në përmbushje edhe të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për strehimin social, i ka kushtuar vëmendje të veçantë parimit të pjesëmarrjes dhe parimit të transparencës dhe informimit të publikut, të parashikuar shprehimisht në nenin 8 dhe 9, të ligjit nr. 22/2018, të ndryshuar sipas të cilave përcaktohet se çdo subjekt që zbaton një program social strehimi përfshin në proces konsultimi komunitetin që preket dhe/ose atë që përfiton nga programi, në përputhje me ligjin nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” si dhe detyrimin e organeve të njësisë të vetëqeverisjes vendore për të siguruar informimin e qytetarëve rreth llojit të programit social të strehimit që zbatohet në atë njësi të vetëqeverisjes vendore, kushtet që duhet të plotësojnë subjektet e interesuara për t’u përfshirë në programin specifik të strehimit, dokumentacionin që kërkohet për verifikimin e të dhënave që

deklaron subjekti i interesuar, procedurën që do të ndiqet nga njësia e vetëqeverisjes vendore për miratimin e përfituesve etj.

Për rrjedhojë, duke analizuar bazën ligjore të sipërcituar, sqarojmë se këto procese nuk përmbushin cilësitë e nevojshme për t'u konsideruar si veprimtari të ndaluara, pasi nuk janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, por janë ndjekur/zbatuar në vazhdimësi, sipas parashikimeve të akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë fushën e strehimit social.

*Për sa më sipër, Bashkia Tiranë, në funksion të garantimit transparencës të veprimtarive publike në zbatim të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, të ndryshuar, ka raportuar aktivitetin në fjalë, **i cili nuk është zhvilluar më datë 23.2.2025**".*

Në bazë të raportit të monitoruesit në terren, bashkëlidhur këtij vendimi, rezulton se: *"Gjatë periudhës së monitoruar nuk u konstatua asnjë shkelje, pasi aktiviteti nuk u zhvillua në ditën dhe orën e raportuar në veprimtarinë publike"*

Për sa më sipër, pasi u njoha me arsyet e paraqitura nga ana e personit përgjegjës për raportimet dhe raportit të monitoruesit të veprimtarive publike, vlerësohet se në kushtet kur veprimtaria e raportuar nuk është zhvilluar në datën dhe orën e raportuar, pas marrjes së vendimit të ndalimit, nuk jemi në kushtet e shkeljes administrative.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronja "n", nenit 91 dhe 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator "Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve", i ndryshuar,

V E N D O S:

1. Pushimin e hetimit administrativ ndaj Bashkisë Tiranë.
2. Ky vendim njoftohet nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI